



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 88 datë 30.03.2026

**PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT TË INFRASTRUKTURËS PËR  
OBJEKTIN: “NDËRTIMI I LINJËS SË RE ME NJË QARK 220 KV PËR LIDHJEN E  
PARKUT VOLTAIK EZ5 ME RRJETIN ENERGJITIK”, ME VENDNDODHJE NË  
BASHKINË FIER**

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës për objektin: “Ndërtimi i linjës së re me një qark 220 kv për lidhjen e parkut voltaik EZ5 me rrjetin energjitik”, me vendndodhje në Bashkinë Fier, me subjekt zhvillues shoqërinë “EZ-5 Energy” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuesit vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Fier.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
E NEA KARAKACI



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 07/05 2026